

**Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, d.o.o., Sllovenia dhe IVIKOM Holding GmbH mbi shoqëritë Slavonia Pauer d.o.o., Republika e Kroacisë, dhe Bilogora Pauer d.o.o., Republika e Kroacisë**

**(lënda nr. 08-97 / 2024)**

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 24.06.2024, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, doo me seli të regjistruar në adresën rruga Verovškova 55A, 1000 Lubjana, Slloveni dhe IVIKOM Holding GmbH me seli të regjistruar në adresën Viedner Hauptshtasse 76/2/1, A-1040 Vjenë, Republika e Austrisë mbi shoqëritë Slavonia Pauer doo me seli të regjistruar në adresën Damira Tomlanoviqa – Gavrana 11, 10000 Zagreb, Republika e Kroacisë, dhe Bilogora Pauer doo me seli të regjistruar në adresën Damira Tomlanoviqa – Gavrana 11, 10000 Zagreb, Republika e Kroacisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

**-ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, d.o.o.** është një shoqëri sllovene për menaxhimin e fondeve të investimeve alternative, e themeluar në fund të vitit 2020, me një aktivitet kryesor të regjistruar – menaxhimin e fondeve. ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, doo menaxhon një fond investimi të specializuar për burimet e energjisë së gjelbër ALFI, Fondi Special i Investimeve, me seli të regjistruar në adresën Rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjana, Republika e Sllovenisë, („**ALFI Grin Enerxhi Fond**”), e cila kryen veprimtarinë e investimit të mjeteve, të mbledhura nga investitorë të ndryshëm sipas politikës së saj investuese, në termocentralet e erës dhe fotovoltaike që prodhojnë energji elektrike nëpërmjet transformimit të energjisë së erës dhe diellit si burime natyrore të rinovueshme, mundësisht në fazën e ndërtimit ose në fazën e mëvonshme të zhvillimit.

Grupi Alfi në një kuptim më të gjerë (i cili përfshin ALFI Renuables dhe ALFI Grin Enerxhi Fond) ka një prani të regjistruar në praninë lokale përmes shoqërive të varura indirekte dhe fiton të ardhura në Maqedoninë e Veriut përmes (i) shitjes me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesorëve për fëmijë dhe produkte tekstile për fëmijë, si dhe (ii) aktivitete këshilluese në fushën e teknologjisë së informacionit.

**-IVIKOM Holding GmbH** është shoqëria holding e Grupit IVIKOM, e cila është e angazhuar kryesisht në këshillimin, ndërtimin dhe menaxhimin e termocentraleve me erë. IVIKOM u themelua në vitin 2021, pas ndarjes nga shoqëria Ivikom Konsalting, e cila u themelua në Republikën e Austrisë në vitin 1991. Përveç aktiviteteve të përmendura, IVIKOM merret me kërkimin e potencialit të erës dhe zhvillimin e projekteve të termocentraleve me erë.

Grupi IVIKOM nuk është i pranishëm dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

**Slavonia Pauer d.o.o.** u themelua në janar 2022, si një kompani për qëllime të veçanta (në Eng. Special purpose vehicle) me qëllim zhvillimin e termocentralit fotovoltaiak „*Trenkovo*”, me një fuqi të lidhur prej 9,99 MW, në komunën e Trenkovës, Republika e Kroacisë. Shoqëria Slavonia Pauer zotëron mjete, leje dhe të drejta të caktuara për zhvillimin dhe ndërtimin e termocentralit fotovoltaiak „*Trenkovo*”.

Shoqëria Slavonia Pauer d.o.o. nuk është ende aktive në treg, nuk ka kapacitete të instaluara dhe nuk ka arritur asnjë të ardhur, por pas përfundimit të ndërtimit të termocentralit fotovoltaik „Trenkovo” në Republikën e Kroacisë do të kryejë veprimtarinë e eksploatimit të termocentralit fotovoltaik, gjegjësisht prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike të përfituar nga energjia diellore.

Slavonia Pauer d.o.o. nuk gjeneron të ardhura dhe nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

**-Bilogora Pauer d.o.o** u themelua në mars 2023, si një shoqëri për qëllime të veçanta (në Eng. Special purpose vehicle) me qëllim zhvillimin e termocentralit fotovoltaik „Velika Pisanica”, me një fuqi të lidhur prej 5.8 MW, në komunën „Velika Pisanica”, Republika e Kroacisë. Shoqëria Bilogora Pauer zotëron mjete, leje dhe të drejta të caktuara për zhvillimin dhe ndërtimin e termocentralit fotovoltaik „Velika Pisanica”.

Shoqëria Bilogora Pauer doo nuk është ende aktive në treg, nuk ka kapacitete të instaluara dhe nuk ka arritur asnjë të ardhur, por pas përfundimit të ndërtimit të termocentralit fotovoltaik „Velika Pisanica” në Republikën e Kroacisë do të kryejë veprimtarinë e eksploatimit të termocentralit fotovoltaik, gjegjësisht prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike të përfituar nga energjia diellore.

Bilogora Pauer doo nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Tregu përkatës i mallrave për përqendrimin në fjalë duhet të përkufizohet si **treg për prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike me shumicë**.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

26.06. 2024

Shkup